

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2022”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është miratimi i buxhetit faktik të vitit 2022.

Objektivi që synohet është plotësimi i kërkesës ligjore të neneve 62 dhe 63, të ligjit nr.9936 datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2022, të llogarive vjetore për transaksionet financiare të entiteteve të qeverisjes së përgjithshme (qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe të trajtimit të pronave) dhe informimin për arritjen e objektivave, situatën e menaxhimit, të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj lidhet me prioritetet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Sektor publik i besueshëm, eficient dhe transparent”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj ka për qëllim publikimin e informacionit të plotë për performancën makro-fiskale dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2022, objektivat e arritur dhe produktet e realizuara nga çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në harmoni me Kushtetutën dhe në përputhje me nenet 62 dhe 63, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj lidhet me prioritetin e BE-së, “*Rule of law*”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban dy nene.

Neni 1 “Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit”, përmes së cilit miratohet raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit për vitin 2022, sipas dokumenteve të mëposhtme:

- a) Pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, për vitin 2022;
- b) Raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2022, në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;
- c) Raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2022;
- ç) Raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës, për vitin 2022;
- d) Raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit 2022.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektligjit kanë kontribuar strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të njërive të qeverisjes së përgjithshme.

VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e projektligjit është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk shoqërohet me të ardhura apo shpenzime buxhetore.

KËSHILLI I MINISTRAVE